REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
NJËSIA E AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. Prot **Bilisht , më / /2025**

M I R A T O I
KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

Lënda: Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm për vitet 2026-2028,Bashkia Devoll.

KRYETARIT TË BASHKISË DEVOLL

I. PLANIT STRATEGJIK

Qëllimi i Planit Strategjik dhe misioni i NjAB

Qëllimi ynë në hartimin e planit strategjik për periudhën e ardhshme 3- vjeçare (1+ 2 vjet) 2026-2028), është të realizojmë forcimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, shtimin e vlerës së institucioneve publike përmirësimin e qeverisjes, mbrojtjen e interesave të taksapaguesve, maksimizimin e kapaciteteve të ekipit auditues, dhe zgjerimin e mbështetjes në arritjen e objektivave të Bashkisë Devoll.Ai do të konsiderojë përveç kësaj menaxhimin efektiv të burimeve të auditimit,stafit ,kohës së punës dhe kostos së auditimit.

Misioni

Misioni i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, si pjesë e strukturës të Bashkisë Devoll është orientimi i veprimtarisë planifikuar në mënyrë të pavaruar dhe profesionale, duke i dhënë garanci të arsyeshme për efiçencën, efektivitetin dhe ekonomicitetin e menaxhimit të burimeve, përmirësimin e sistemet të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut. Kjo njësi erealizon këtë mision duke zbatuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, rregullat e tjera në fushën e procedurave të Auditimit, ndjekjen e praktikave më të mira bashkëkohore dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të Auditimit, me qëllim kontributin në përmirësimin e drejtimit.

Organizimi i NjAB dhe Kuadri Ligjor

Organizimi i NjAB

Njësia e Auditit të Brendshëm nga ana organizative,është pjesë përbërëse e strukturës organizative të bashkisë dhe i shërben gjithë linjës së menaxhimit të saj.

Nga ana funksionale Njësia e Auditit të Brendshëm funksionon në zbatim të Ligjit Nr.114,datë 22.10.2015"Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik",i ndryshuar,Manualin e Auditit të Brendshëm i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100,datë 25.10.2016,i ndryshuar dhe rregullave e standarteve të nxjerra nga Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Finacave.

Njësia e Auditimit Brendshëm në Bashkinë Devoll funksionon sipas strukturës organike të miratuar në Këshillin Bashkiak. Është e organizuar në nivel sektori me vartësi direkte nga Kryetari i Bashkisë. Njësia përbëhet nga 2 punonjës 1 përgjegjës dhe 1 specialistë dhe raporton direkt të Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak ,meqënëse nuk kemi Komitet të Auditimit të Brendshëm/Këshill Mbilqyrës/Administrati/Borde .

Kuadri ligjor

Veprimtaria e Njësisë së Auditit të Brendshëm në Njësitë Publike (në këtë rast Bashkia Devoll bazohet në:

- Ligji nr 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",i ndryshuar;
- Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave me nr. 100 datë 25.10.2016,i ndryshuar;
- Ligji nr 139/2015 datë17.12.2015"Për vetqeverisjen vendore",i ndryhuar;
- Standarteve Globale të Auditimit të Brendshëm;
- Urdhërin nr.103,datë 23.07.2025 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Standarteve Globale të Auditimit të Brendshëm të pranuara për zbatim në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë";
- V.K.M Nr. 83, datë 03.02.2018 "Për miratimin e kritereve për ngritjen enjësive të auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik".
- Etj.

Objektivat Strategjike.

Bazuar në misionin dhe vizionin , Njësia e Auditimit Brendshëm, Bashkia Devoll ka vendosur këto objektiva strategjike për periudhën 2026-2028, të cilat janë:

1. Forcimi i qeverisjes së brendshme
- Vlerësimi i efektivitetit të strukturave të qeverisjes, politikave dhe procedurave. Sigurimi që vendimmarrja bazohet në transparencë, integritet dhe llogaridhënie.
2. Përmirësimi i menaxhimit të riskut
- Identifikimi, analiza dhe vlerësimi i risqeve që ndikojnë në arritjen e objektivave strategjike. Ofrimi i rekomandimeve për minimizimin e risqeve dhe përmirësimin e kontrolleve.
3. Rritja e efektivitetit të kontrolleve të brendshme
- Vlerësimi i mjaftueshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve ekzistuese. Sugjerimi i masave për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

4. Mbështetja e performancës organizative

- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e efikasitetit dhe ekonomicitetit në përdorimin e burimeve. Nxitja e kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm.

5. Zhvillimi profesional i funksionit të auditimit të brendshëm

- Përdorimi i standardeve ndërkombëtare të praktikës profesionale të auditimit të brendshëm (IIA). Trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i auditorëve për të siguruar kompetencë dhe pavarësi.

6. Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me palët e interesuara

- Ndërtimi i marrëdhënieve efektive me menaxhimin, bordet dhe njësitë e tjera të kontrollit. Raportim i qartë, objektiv dhe në kohë për rezultatet e auditimeve.

Identifikimi i subjekteve

Nr.	Viti i parë 2026	Viti i dytë 2027	Viti i tretë 2028
1	Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit , vlerësimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura (Situatës së Borxhit) në Bashkinë Devoll.	Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit , vlerësimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura (Situatës së Borxhit) në Bashkinë Devoll.	Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit , vlerësimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura (Situatës së Borxhit) në Bashkinë Devoll.
2	Vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm,për tu kryer në periudhën Janar-Mars.	Vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm,pë tu kryer në periudhën Janar-Mars.	Vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm,pë tu kryer në periudhën Janar-Mars.
3	Sektori i Projekteve dhe Integrimit në BE dhe Diasporën, vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE përfituese të këtyre fondeve.	Sektori i Projekteve dhe Integrimit në BE dhe Diasporën, vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE përfituese të këtyre fondeve.	Drejtoria e të Ardhurave Lejave dhe Mbledhjes së Borxhit.
4	Drejtoria e Shërbimeve Sociale,Shëndetësore dhe Strehimit.	Drejtiria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit.	Sektori i Projekteve dhe Integrimit në BE, vlerësimin

			e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE përfituese të këtyre fondeve
5	Auditim në Bashkinë Pustec.	Drejtoria e Shërbimeve Juridike,Prokurimeve dhe Zbatimit të Kontratave.	Drejtoria e Bujqësisë
6	Njësia Administrative Miras;Njësia Administrative Hoçisht;Njësia Administrative Progër;Njësia Administrative Qendër Bilisht;	Drejtoria e Urbanistikës.	Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit.
7	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore,IT dhe Protokoll/Arkivë .	Drejtoria e Shërbimeve Utilitare komunitare dhe Administrative	Drejtoria e Arsim,Kulturës,Rinisë dhe Sporteve.

Plani strategjik është ndërtuar për një periudhë 3 vjecare (2+1), për vitet 2026- 2028, janë parashikuar për Auditim 21 subjekte.

Planifikimi Strategjik i ndarë sipas viteve, është bërë duke u bazuar në nivelin e riskut që paraqesin subjektet që do të auditohen dhe diskutimin me Menaxhimin e lartë.

Për vitin 2025 janë planifikuar për auditim 7 subjekte, nga të cilat 5 angazhime auditimi përputhshmëri, dhe 2 angazhim auditimi performancë ,sipas rasteve të paraqitura (bashkelidhet pasqyra nr.03).

Identifikimi i fushave apo sistemeve prioritare

• Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit , vlerësimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura (Situatës së Borxhit) në Bashkinë Devoll.
Vlerësim i sistemit të detyrimeve të prapambetura;Vlerësimi paraprak i lindjes së detyrimeve;Regjistrimi në kontabilitet; Verifikimi i shlyerjes së detyrimeve;Të tjera.
• Vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm, pë tu kryer në periudhën Janar-Mars.
➢ Vlerësimin e sistemit të statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm.
➢ Të tjera.
• Sektori i Projekteve dhe Integrimit në BE, vlerësimin e përshtatshmërisë dhe

efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE përfituese të këtyre fondeve
➢ Vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE edhe vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE.
➢ Të tjera.
• Drejtoria e Shërbimeve Sociale,Shëndetësore dhe Strehimit.
➢ Sektori i Ndihmës Ekonomike. ➢ Qendra Sociale Multifunksionale. ➢ Të tjera.
• Auditim në Bashkinë Pustec:Sektori i Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit , vlerësimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura (Situatës së Borxhit) në Bashkinë Pustec.Sektori i Tatim Taksave.Prokurimet Publike.
➢ Sistemi i Monitorimit të funksionimit të kontrollit të brendshëm;vlerësimi i sistemit të detyrimeve të prapambetura; ➢ Vleresimi i procesit të planifikimit vjetor të të ardhurave taksav/tarifa vendore. Krahasimi i të ardhurave të planifikuara me ato të realizuara. Auditim mbi menaxhimi e borxhit tatimor dhe rritja nga një periudhë në tjetrën, saktësisa dhe përditësimi i listës së debitorëve ,regjistrimi i bizneseve të reja ➢ Auditim mbi procedurat e prokurimit,zbatimin e kontratave,kryesisht ato me burim financimi nga fondet e veta.Të tjera. ➢ Të tjera.
• Auditim në:Njësia Administrative Miras;Njësia Administrative Hoçisht;Njësia Administrative Progër;Njësia Administrative Qendër Bilisht
➢ Sistemi i informimi mbi kryerjen e punimeve e sherbimeve nga sektori i shërbimeve,mirembajtje,funeralit dhe varezave,Të tjera.
• Auditim në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore,IT dhe Protokoll/Arkivë
Sistemi për Burimet Njerëzore;Sistemi për statistikën;Sistemi i respektimit të strukturës & organikës dhe pagës.Rekrutimet;sistemi për shërbimet e brendshme;protokoll-arshiven;IT-në,Të tjera.

Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve.

Identifikimi i risqeve është mbështetur **në procesin e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve** të kryer nga njësia e auditimit të brendshëm (që kryet një herë në vit),për të gjitha subjektet që përfshihen në universin e auditimit,me qëllim që të sigurohet prioritarizimi i auditimeve mbi bazën e nivelit të riskut të vlerësuar,duke respektuar parimin që të gjitha sistemet me risk të lartë të auditohen çdo vit në vitin e dytë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e parë dhe në vitin e tretë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e dytë por duhet respektuar frekuenca jo më shumë se 5 vjet.

Gjatë hartimit të planittë auditimeve u morrën në konsideratë edhe,**diskutimi me Menaxhimin e Lartë** .

Gjatë përgatitjes së planit strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm për

vitet 2026-2028 janë marrë parasysh këshillat praktike mbi përgatitjen e "Planit starategjik dhe vjetor të veprimtarisë të njësisë së auditimit të brendshëm për vitet 2026-2028",dërguar me shkresë me nr.13111 prot,datë 10.09.2025 nga MFE,DPHKBFP dhe DHAB si më poshtë vijojnë:

1. Plani Strategjik dhe vjetor,miratohet nga titullari i institucionit,pas procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga strukturat këshilluese e drejtuese,sikuse janë;Komiteti i Auditimit të Brendshëm/Këshilli Mbikqyrës/Administrativ/Borde,etj(nëse ka).
2. Drejtuesi i NJAB të harojë një strategji për fuksionin e auditimit të brendshëm në mbështetje të objektivave strategjike dhe suksesin e organizatës dhe përputhet me pritshmëritë e menaxhimit të lartë dhe aktorëve të tjerë kryesorë.

   a)Vizionin dhe objektivat starategjike të funksionimit të auditimit të brendshëm;

   b)Identifikimin dhe analizën e pikave të forta,dobësive,mundësive dhe kërc5nimeve të auditimit të brendshëm(analiza(SËOT),apo një analizë të kufizimit midis gjendjes aktuale dhe asaj të dëshiruar;

   c)iniciativat dhe aktivitetet që mbështesin objektivat startegjike në përshtatje me objektivat strategjike të organizatës;c)përshtatjen e strategjisë në rast të ndryshimeve në:objektivat strategjike dhe strategjinë e organizatës,politikat dhe procedurat e organizatës,menaxhimit të rriskut dhe kontrollit.
3. Drejtuesi i NJAB ,të dokumentojë metodologjitë që janë të nevojshme për të udhëhequr funksionin e auditimit të brendshëm,zbatimin e strategjisë dhe realizimin e planit të auditimit të brendshëm,të cilat ndihmojnë audituesit e brendshëm të zbatojnë standartet dhe të kryejnë shërbimet me cilësi.Metodologjitë që përfshijnë qasjen e funksionimit të auditimit të brendshëm për:
   a) Vlerësim të reziqeve për organizatën dhe për çdo angazhim,
   b) Zhvillim dhe përditësim të planit të auditimit të brendshëm,
   c) Përcaktimin e ekuilibrit ndërmjet angazhimeve të siguritmit dhe këshillimit,
   d) Koordinimin me ofruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë.
4. Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të përcaktojë dhe të karakterizojë një **univers gjithëpërfshirës dhe të plotë të auditimit**,i cili:
   a) Bazohet në të kuptuarit e objektivave të organizatës,në strukturën dhe kornizën e rezikut të organizatës.
   b) Mbulon:

- Të gjitha subjektet që i nënshtrohen varësisë administrative dhe /ose strukturat brenda linjës së menaxhimit(Drejtoritë pranë institucionit/njësisë publike),për të cilat përgjigjet për administrimin dhe auditimin e këtyre subjekteve,që janë në fushën e autoritetit të njësisë publike pavarësisht se në çfarë periudhe gjykohet të auditohet.
- Reziqet kryesore të organizatës,fushta,sistemet,funksionet,proceset,programet si dhe projektet e njësisë.

Drejtuesi i NJAB të kryejë përditësimin e vlerësimit të rezikut dhe university ekzistues të auditimit në përputhje me objektivat e reja,ndryshimet që ndollin në organizatë,në lidhje me

procesetqeverisjes,menaxhimit të riskut dhe kontrollit të organizatës,me qëllim krijimin e një universi auditimi të përshtatshëm për procesin e planifikimit strategjik dhe vjetor.

5. Strategjia e auditimit të brendshëm duhet të sigurojë që:

   a)procesi për identifikimin dhe vlerësimin e reziqeve të përfshijë reziqet e rëndësishme,reziqet e reja dhe në zhvillim që duhet të merren parasysh për mbulimin në planin e auditimit,

   b)Vlerësimi i risqeve të përfshijë të gjithë periudhën startegjike të auditimit dhe jo vetëm vitin e ardhshëm,

   c)Njësitë,strukturat,sistemet,fushat dhe veprimtaritë kryesore,të cilat janë vlerësuar me një nivel të larytë risku,të parashikohen për auditim me një frekuesncë më të shpeshtë,në mënyrë që të mbahet nën kontroll ndryshimi i nivelit të riskut,duke i dhënë prioritet atyre me risk më të lartë.

6. Qasja e Planifikimit Strategjik dhe Vjetor mbështetet në **procesin e identifikimin dhe vlerësimin të risqeve**(që kryet nga njësia e auditimit të brendshëm të paktën një herë në vit)për të gjithë subjektet që përfshihen <u>në universin e auditimit</u>,me qëllim që të sigurohet prioritarizimi i auditimeve bazuar në nivelin e riskut të vlerësuar,duke respektuar renditjen që të gjitha sistemet dhe /apo subjektet me risk të lartë të auditohen çdo vit.Përveç kësaj,gjatë hartimit të planit të auditimeve **duhen marrë në konsideratë** edhe sygjerimet,opinionet apo propozimet e dokumentuara **nga menaxhimi** të cilat lidhen kryesisht me angazhimet këshillimore(shërbimet e këshillimit),me qëllim përmirësimin e menaxhimit të risqeve,shtimin e vlerës dhe përmirësimin e veprimtarisë sënjësisë publike.
7. Procesi **i identifikimit dhe vlerësimit të përgjithshëm të riskut**(i dokumentuar)të kryet pas sishikimit të formateve standarde,pikërisht:
   - Formati standard nr.1; :Pyetesor për mjedisin e kontrollit të brendshëm";
   - Formatit nr.2 Pyetësot për planin Strategjik-Të kuptosh procedurat e Auditimit të Brendshëm";
   - Formatit standard nr.3 "Identifikimi i sistemeve të njësisë".

Rezultatet dhe dokumentimi i procesit të vlerësimit të riskut **duhet të jetë pjesë e dosjes së planifikimit**,duke shërbyer si bazë për përcaktimin e prioriteteve në auditim.

Etj.
Në subjektet e identifikuara për auditim për vitin 2025. janë vlersuar me risk te lartë3 subjekte, me risk te mesem 5 subjekte (bashkelidhet pasqyra nr.02).

Kufizimet e Auditimit.
Njësia e Auditimit – Bashkia Devoll, është e pavaruar në kryerjen e misionit të auditimit. Gjatë kryerjes misioni i auditimit nuk ka hasur pengesa në realizimin e objektivave , kryesisht në venien në kohë të dokumentaconit të nevojshem për auditim, paraqitja e argumenteve të ndryshme nga të audituarit, kundërshtime pa u bazuar në fakte ligjore. Bashkia Devoll ka subjekte të largët.

Prioritetet për të ardhmen,për vitet (1+2).

Njësia e Auditimit – Bashkia Devoll, për të bërë të mundur përmirsimin e punës audituese, si prioritet kryesor do të ketë;

- Rritja e cilësisë dhe e performancës së audituesve duke shtuar numrin e zbulimeve si dhe impaktit në rritje përsa i përket shtimit të vlerës.
- Konsulencave të vazhdueshme me drejtuesit e nivelit të ulët dhe të lartë të Bashkisë Devoll për të bërë të mundur eleminimin në kohë të mangësive.
- Bashkëpunimi cilësor me subjektet e audituara për hartimin dhe zbatimin e rekomandimeve.
- Menaxhim efektiv i burimeve të auditimit,bazuar në aftësitë profesionale.
- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të punonjësve të auditit të brendshëm nëpërmjet trajnimeve,
- Analizë e plotë e problemeve të konstatuara gjatë misioneve të auditimit, dhe gjetja e mënyrave për përmirsimin e tyre.

II Plani vjetor viti i parë 2025

Zhvillimet aktuale të Njësisë të Auditimit - Bashkia Devoll.

Njësia e Auditimit – Bashkia Devoll është organizuar dhe funksionon në rang sektori dhe zhvillon veprimtarinë e saj në baze të ligjit nr.114,datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Financave Nr. 100/2016 "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", kapitulli i IV-t "*Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit*", Urdhërit Nr. 4, datë 10.01.2020 "*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016*",I ndryshuar dhe planin vjetor dhe strategjik me nr.3060/3 prot,datë 10.10.2024,Standarteve Globale të Auditimit të Brendshëm dhe Kodin e Etikës.Aktualisht në strukturë janë 2 punonjës(1 përgjegjës dhe 1 specialist) të cilët janë të çertifikuar.

Plani Vjetor 2025 u hartua në bazë të planit Strategjik 2026-2028 të aktiviteteve të auditimit të brendshëm,i cili përkufizon tematiken e veprimtarisë ,hapësirat e veprimit në perspektivë,prioritetet në pajtueshmeri me qellimet e subjekteve që auditohen,drejtimet strategjike të zhvillimit të kontrollit të brendshëm të cilat janë të lidjura me Auditimin e Brendshëm,objektivin,objektivat,kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

Plani vjetor mund të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhornohet sipas nevojës,në mënyrë që ti pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në Bashkinë Devoll apo tek anëtarët e sektorit të AB dhe çdo detyrë shtesë të propozuar nga Kryetari i Bashkisë.Ndryshimi i Planit Vjetor miratohet nga Kryetari i Bashkisë.

Në zbatim të planit vjetor për periudhën Janar-Dhjetor 2025 njësia e auditimit të brendshëm do të përfundojë 7- misione auditimi në strukturat e bashkisë sipas planit të auditimit . **Nuk ka pasur ndryshim të planit të auditimeve.**

Subjektet e audituara janë:

1. Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit , vlerësimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura (Situatës së Borxhit) në Bashkinë Devoll.
2. Vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm,që tu kryer në periudhën Janar-Mars.

3. Drejtoria e të Ardhurave Lejave dhe Mbledhjes së Borxhit.
4. Sektori i Projekteve dhe Integrimit në BE, vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE përfituese të këtyre fondeve.
5. Drejtoria e Bujqësisë.
6. Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit.
7. Drejtoria e Arsim,Kulturës,Rinisë dhe Sporteve.

Përqindja e realizimit të auditimeve deri tani është 71.5% e planit dhe deri në fund të vitit mendoj se do të realiozohet 100% të misioneve të planifikuara,nuk ka pasur shmangie nga plani.

Prioritetet e auditimit për vitin 2026.

Është e rëndësishme që planifikimi i veprimtarisë audituese vjetore të jetë i integruar me planin strategjik dhe i ndërtuar në mënyrë të tillë që ai të jetë i zbatueshëm.

Po listojmë disa nga prioritetet.

-Zhvillimi i veprimtarisë në përputhje me praktikat e mira profesionale.
-Menaxhimi efektiv i burimeve të auditimit,bazuar në aftesitë profesionale.
-Ndjekja e trajnimeve të vijueshme dhe çertifikimit të Audituesve të brendshëm.
-Rritja e cilësisë dhe performancës së audituesve duke shtuar cilësinë e zbulimeve dhe rekomandimeve me qëllim dhënien e impaktit në ritje përsa i përket përmiresimit të menaxhimit dhe shtimit të vlerës.
-Shfrytezimi i burimeve njerëzore të sektorit në mënyrë efektive dhe eficente.

Objektivat e auditimit për vitin 2025.

Për vitin 2024, Njësia e Auditimit- Bashkia Devoll ka vendosur obektivat si me poshtë;

1.Përmirësimi i standarteve profesionale.
2.Orientimi i auditimit në proçese që kanë risk të lartë.
3.Dhënia e Rekomandimeve në përmirsimin e punës.
4.Dhënia e këshillimit dhe sigurisë për Titullarin e Bashkisë Devoll.
5.Infrmacioni thelbësor financiar,menaxherial dhe operacional i saktë,i besueshëm dh në kohë.
6.Burimet sigurohen me ekonomicitet,përdoren me efiçencë, dhe mbrohen me korektësi.
7.Programet,planet dhe objektivat realizohen.

Programimi i llojit të angazhimeve.

Njësia e Auditit te Brendshëm ka planifikuar 7- subjkete kryesore për të audituar gjatë vitit 2026 me qëllim mbulimin me auditim të sistemeve/fushave kryesore në strukturat përkatëse.

Paraqitja në formë tabelare.

Nr.	Bashkia Devoll	Fushat e Auditimit	Nr. Auditimeve	Lloji i Angazhimit
1	Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit , vlerësimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura (Situatës së Borxhit) në Bashkinë Devoll.	Vlerësim i sistemit të detyrimeve të prapambetu detyrimeve;Regjistrimi në kontabilitet; detyrimeve;Të tjera	1	Përputhshmëri.
2	Vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm,për tu kryer në periudhën Janar-Mars.	Vlerësimin e sistemit të statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm.	1	Përputhshmëri.
3	Sektori i Projekteve dhe Integrimit në BE dhe Diasporën, vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE përfituese të këtyre fondeve.	Projektet e BE; Vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE,etj.	1	Performancë.

mi paraprak
Verifi

4	Drejtoria e Shërbimeve Sociale,Shëndetësore dhe Strehimit.	Sistemi i dokumentacionit të ndihmës ekonomike,Sistemi i pagesës së ndihmës ekonomike,Streimi,çështjet sociale,mbrojtja e fëmijve etj,Ndihma ekonomike,pagesat 6%,etj.	1	Përputhsh mëri.
5	Auditim në Bashkinë Pustec:Sektori i Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit , vlerësimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura (Situatës së Borxhit) në Bashkinë Pustec.Sektori i Tatim Taksave.Prokurimet Publike.	Sistemi iMonitorimit të funksionimit të kontrollit të brendshëm;vlerësimi i sistemit të detyrimeve të prapambetura;Vleresimi i procesit të planifikimit vjetor të të ardhurave taksav/tarifa vendore.Krahasimi i të ardhurave të planifikuara me ato të realizuara. Auditim mbi menaxhimi e borxhit tatimor dhe rritja nga një periudhë në tjetrën, saktësisa dhe përditësimi i listës së debitorëve ,regjistrimi i bizneseve të reja ;Auditim mbi procedurat e prokurimit,zbatimin e kontratave,kryesisht ato me burim financimi nga fondet e veta.Të tjera.	1	Përputhsh mëri.
6	Njësia Administrative Miras;Njësia Administrative Hoçisht;Njësia Administrative Progër;Njësia Administrative Qendër Bilisht;	Shërbimi ndaj komunitetit të njësive.Informimi dhe këshillimi i fermerëve të njësive përkatëseSistemi i informimi mbi kryerjen e punimeve e sherbimeve nga sektori i shërbimeve,mirëmbajtej,funeralit dhe varezave,etj	1	Përputhsh mëri.
7	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore,IT dhe Protokoll/Arkivë	Sistemi për Burimet Njerëzore;Sistemi për statistikën;Sistemi i respektimit të strukturës & organikës dhe pagës.Rekrutimet;sistemi	1	Performan cë.

		për shërbimet e brendshme;protokoll-arshiven;IT-ne,Të tjera.		

Planifikimi i kostos për vitin 2026.

Kostoja e auditmit është përllogaritur duke marrë parasysh të dhënat aktuale mbi numurin e audituesve si dhe treguesit aktualë mbi pagat dhe shërbimet e tjera si kancelari e shtypshkrime,udhëtime e dieta pa llogaritur energjinë dhe ujin.Në bazë të llogaritjes kosto për person për vitin 2026 aktual është rreth 1,163 mijë/lek.

Planifikimi i burimeve për vitin 2026.

Plani vjetor dhe strategjik për periudhën 2025-2027 është përgatitur mbi bazen e burmeve njërezore aktuale në dispozcion.Llogaritja është kryer bazuar në ditët e punës të vlefshme në vit,pa përfshirë pushimet vjetore dhe festat zyrtare si dhe njerëz audites që janë në stafin e sektorit të njësisë së auditimit për vitin2025.Nga koha efektive e punës në ditë/njerëz janë zbritur ditë/njerëz që nevojiten për pushime vjetore,festa zyrtre,pushimet javore,pushime për arsye shëndetësre trajnime dhe angazime të tjera si takime mbledhje etj.Referuar këtyre teguesve garantohet realizimi i planit të auditimeve për vitin 2025.
Në rast ndryshimeve të strukturës organizative ,plani vjetor i strukturës së Auditit të Brendshëm do të rishikohet për tu përshtatur me kerkesat e reja të Bashkisë.

Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Për vitin 2026 janë planifikuar 5 ditë trajnime për të plotësuar dhe kërkesat ligjore prej 40 orë trajnime në vit , si dhe 5 ditë kualifikime të ndryshme të planifikuara nga Bashkia apo të tretë.Aktualisht Njësia e Auditit të Brendshëm funksionon vetëm me 1 (një) përgjegjës dhe 1(një) specialistë.Me qëllim rritjen profesionale të audituseve dhe përvitesimin e njohurive të fituara deri më tani janë përcaktuar nevojat dhe janë janë identifikuar temat për trajnim sipas pasqyrës nr,4 bashkëlidhur.Meqenëse misioni i angazhimit kryhet në grup dhe secili pjsëtar i grupit është i interesuar për temat e identifikuara është përcaktuar e njëjta periudhë trajnimi për të tre audituesit,si dhe mundësia e çertifikimit të 1(një)specialisti(të paçertifikuar).

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Sigurimi i brendshëm i cilësisë do të kryehet nga drejtuesi i NJAB .sipas programit **<u>për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë që kryhet nga vetë NjAB,</u>**miratuar nga titullari i institucionit.

Njësia e auditit të brendshëm duke filluar me vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.Drejturesi i Njësisë së Auditit të Brendshëm përgatit dhe e miraton ne titullati i institucionit Programin **<u>për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë që kryhet nga vetë NjAB</u>** i përbërë nga komponentët e mëposhtëm:

Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së veprimtarisë së auditimit të brendshëm . Monitorimi i veprimtarisë së auditimit, nga vetë audituesit që e kryejnë është pjesë integrale e Programit të Përmirësimit dhe të Vlerësimit të Cilësisë brenda funksionit të auditimit të brendshëm. Drejtuesi i Njësisë së auditit të brendshëm është përgjegjës për monitorimin e vazhdueshëm.

Vetë-Vlerësim periodik nga njësia e auditimit të brendshëm .Vetëvlerësimi periodik është një tjetër komponent integral i programit të sigurimit të cilësisë në kuadërtë funksionit të auditimit të brendshëm. Këto vlerësime kryhen për të vlerësuar përputhshmërinë me parimet bazë të Strukturës Ndërkombëtare për Praktikat Profesionale (IPPF) të auditimit të brendshëm, si: përkufizimi i auditimit të brendshëm, Kodi i Etikës, standardet ndërkombëtare dhe me kërkesat specifike të manualit të auditimit të brendshëm. Një audites ose grup audituesish brenda njësisë së auditimit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme të praktikave të mira të auditimit duhet tëkryejnë vetëvlerësimin periodik.

Të cilët do të verifikojnë procedurat e ndjekura në mbeshtjetje të manualit të auditimit dhe programit të angazhimit,duke permbushur detyrat konform kërkesave metodologjike,duke ndjekur të gjitha fazat e auditimit deri në dorëzimin e plotë të dosjes.

Në zbatim të planit strategjik, është hartuar plani vjetor për vitin e parë 2026.

Bashkëngjtur japim informacion skematik për detaje lidhur me aktivitetin e punës së Njësisë së Auditit të Brendshëm për vitin e parë 2026,si dhe planifikimin strategjik për vitet 2026,2027,2087.(përfshi vtin e parë).P.sh

Aneksi nr. 1: Vlerësimi i nivelit të riskut për të gjithë subjektet që duhet të auditohen nga NjAB

Aneksi nr.2:. Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2026,2027,2028.

Aneksi nr. 3: Plani i angzhimeve të NjAB për vitin 2026.

Aneksi nr. 4:. Planifikimi vjetor i nevojave për tajnime të NJAB për vitin e parë 2026.

Aneksi nr. 5:. Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve njerëzore për vitin 2026.

Çdo vit do të bëhen ndryshime në planin fillestar nëse është e nevojshme duke marrë miratimin nga ana e Kryetarit.

Drejtuesi i NjAB

Përgjegjësi
Anida Kaso